

**AKTI I THEMELIMIT I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"O&A Corporation" shpk**

Sot, Më datë 03/06/2024, shoqëria krijohet nga ortaku i vetëm themelues:

Z.Oles Zvarych, shtetas ukrainas, identifikuar me pasaportë nr.FN954591, i datëlindjes 06/08/1990, lindur në Ukrainë dhe banues në Ukrainë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 1:  
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është "O&A Corporation" shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:  
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :

Aktivitete të pasurive të paluajtshme, Aktivitete të agjencive të punësimit, Programime, këshillime dhe aktivitete të tjera informatike, Agjensi udhëtimi, operator turistik dhe të tjera aktivitete të shërbimit të rezervimit, Hartimi i projekteve të ndërtimit, Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve dhe aktivitete të konsultimit, Aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për manaxhimin. Aktivitete të tjera të telekomunikacionit.

2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:  
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Zona kadastrale nr.3292, numri i pasurisë 153/143-N2, Selitë, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5:**

### **Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë dhe nuk është paguar. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

Z.Oles Zvarych : Zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë që përben 100% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 2) Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta).

### **Neni 6:**

#### **Administratori**

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Z.Oles Zvarych, shtetas ukrainas, identifikuar me pasaportë nr.FN954591, i datëlindjes 06/08/1990, lindur në Ukrainë dhe banues në Ukrainë, me afat emërimi 3 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

### **Neni 7:**

#### **Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 8:**

#### **Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAKËT E SHOQËRISË  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"O&A Corporation" shpk**

**Oles Zvarych**  
(Emër, Mbiemër, Firma)

Oles Zvarych